



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “NSH MVR ELEKTROMONTUES” Sh.P.K. të datës 24.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “NSH MVR ELEKTROMONTUES” Sh.P.K. të datës 24.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “NSH MVR ELEKTROMONTUES” Sh.P.K. (tutje si “parashtruesi”) me datë 24.06.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me numër të prokurimit 616-24-3392-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë formuluar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 - çmimet me të cilat kanë ofertuar Operatorët Ekonomik të rekomanduar për kontratë, respektivisht tenderët e operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe atë tenderi i Besa Company shpk për Loto 2, tenderi i Elektrikamont shpk për Loto 3 dhe tenderi i Risamont shpk për Loto 4, janë çmime/tenderë jo normalisht të ulëta.

Pretendimi nr. 2 - Nga qasja që kemi realizuar në dosjen e tenderit të Operatorit Ekonomik Besa Company shpk, shihet se i njëjti NUK KA PLOTËSUAR FARE ANEKSIN 6 TË DOSJES SË TENDERIT, ku ka qenë obligim sipas kësaj kërkesë që të pLotoësohet ashtu siç përcaktohet në kërkesën e lartcekur të DT. OE Besa Company përmes vendimit të datës 02.05.2024 ka planifikuar të angazhoj si menaxher të projektit për tenderin në fjalë z. Ibush Neziri. Mirëpo, kërkesë e dosjes së tenderit siç u citua më lartë ka qenë që për menaxherin e projektit të dorëzohet Kontrata e punës me punëdhënësin [në këtë rast me Besa Company] ose Marrëveshjen për angazhimin në këtë projekt [pra marrëveshjen për angazhim me Besa Company], e që në rastin konkret nuk është dorëzuar as Kontrata e Punës e as Marrëveshja për angazhim për menaxherin Ibush Neziri. Më tutje, nuk janë dorëzuar as dëshmi për përvojën e punës 5 vjeçare si Menaxher i projekteve. Kështu, referenca e dorëzuar nga vet kompania Besa Company shpk, e datës 24.04.2024 nuk përmbanë dëshmi për kohëzgjatjen e përvojës së menaxherit Ibush Neziri, nuk përmbanë as informacion e as dëshmi se a ka qenë i angazhuar në këto projekte si Menaxher apo në çfarë cilësie, nuk përmbanë as datat e fillimit e as mbarimit të projekteve të specifikuara në këtë referencë në mënyrë që të vërtetohet kohëzgjatja e përvojës në këto projekte. Po ashtu, te CV e tij shihet se nuk shkruan se i njëjti është Inxhinier i elektros.

Pretendimi nr. 3 - për menaxherin e projektit Bekim Hamiti, nga ana e OE Elektrikamont nuk është dorëzuar dëshmia mbi përvojën e punës. Kështu referenca e lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e datës 12.03.2014 nuk përmbanë kohën e mbarimit të punës, që nënkupton se nuk dihet kohëzgjatja e përvojës në këtë institucion. Më tutje, referenca e lëshuar nga Divizioni i Personelit i MPMS-së, nr. prot 922 e datës 11.02.2015, shihet se është lëshuar për pozitën e punës Trajner për elektrikë dhe TI në Qendrën e Trajnimeve Profesionale në Prizren dhe rrjedhimisht përvoja e punës në këtë institucion nuk ndërlidhet me tenderin në fjalë, pra nuk është punë e ngjajshme. Po ashtu edhe referenca e lëshuar nga Hidroterm është për pozitën inxhinier dhe jo Menaxher i Projekteve. 58. Po ashtu, kjo kërkesë nuk është pLotoësuar as për dëshmitë e kërkuara për një inxhinier të elektros i cili duhet të ketë 3 vite përvojë pune, ku OE Elektrikamont ka dorëzuar diplomën për inxhinierin Skender Lezi, por nuk ka dorëzuar as referencë, as CV e as dokument tjetër që dëshmon përvojën e tij të punës 3 vjeçare.

Pretendimi nr. 4 - OE Elektrikamont nuk e ka pLotoësuar fare kolonën D dhe as nuk ka bashkangjitur dokumentet e kërkuara në tërësi për të gjitha mjetet. Ndërsa siç argumentuam më lartë për mjetin Eskavator 4x4 me lugë ngarkuese e ka paraqitur mjetin e njëjtë/identik me mjetin që e ka paraqitur OE Besa Company për këtë kërkesë, ku të dy këta operator kanë siguruar marrëveshje për MJETIN E NJËJTË/IDENTIK NGA KOMPANIA NSHP BAGERI.

Pretendimi nr. 5 - OE Risamont nuk e ka pLotoësuar fare kolonën D dhe as nuk ka bashkangjitur dokumentet e kërkuara në tërësi për të gjitha mjetet. Kërkesa në fjalë nuk është respektuar edhe për faktin se shumica e mjeteve kanë regjistrim të skaduar, siç është kamioni me traga të regjistrimit 01-629-OC, pastaj kamijoni me traga të regjistrimit 01-826-JQ, kamioni kipër me traga të regjistrimit 01-611-MR. Andaj, edhe për këtë arsye OE Risamont duhet të shpallet i papërgjegjshëm dhe të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit dhe me këtë vërtetohet shkelja e nenit 68 dhe 69 e LPP-së nga ana e AK KP. OE Risamont nuk e ka pLotoësuar fare këtë Aneks 6, por vetëm e ka vulosur, e që e bën automatikisht të papërgjegjshëm sepse kërkesa dokumentare dhe aneksi 6 shkruan qartë “Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik dhe Vula” dhe po ashtu në këtë aneks shkruan qartë se “Ky aneks është obligativ që të pLotoësohet dhe ti bashkangjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton përformimin e tillë”. OE Risamont e ka dorëzuar sigurimin e tenderit por pa specifikuar vlerën e sigurimit për secilin Loto, ashtu siç kërkohet me dosjen e tenderit dhe kërkesën nr. 13.2. Andaj, edhe për këtë arsye ky operator ekonomik duhet të shpallet i papërgjegjshëm. Me këtë rast AK KP ka shkelur nenin 57 të LPP-së. 91. Më tutje, te lista e çmimeve, OE Risamont nuk e ka pLotoësuar çmimin për artikullin numër 52. Në këto raste kur nuk pLotoësohet lista e çmimeve, sipas udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, faqe 41, tenderi duhet refuzuar automatikisht. Andaj, konsiderojmë se AK KP ka bërë shkelje kur ka vendosur të rekomandoj për kontratë OE Risamont andaj ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim në mënyrë që për këto arsye OE Risamont të shpallet i papërgjegjshëm.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 1 – është gjetur se çmimet me të cilat kanë ofertuar Operatorët Ekonomik të rekomanduar për kontratë, respektivisht tenderët e operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe atë tenderi i Besa Company shpk për Loto 2, tenderi i Elektrikamont shpk për Loto 3 dhe tenderi i Risamont shpk për Loto 4, janë çmime/tenderë jo normalisht të ulëta. Kjo për arsye se çmimet e tyre janë dukshëm më të ulëta sesa 30% nën mesataren e çmimeve të ofertuesve të përgjegjshëm si dhe dukshëm më të ulët sesa 10% nën çmimin e dytë më të lirë. Kësisoj është gjetur se komisioni vlerësues ka vepruar në kundërshtim me nenin 41 të RRPP ndërsa pretendimi ankimor është i bazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 2 – është gjetur se tenderuesi i rekomanduar Besa Company Sh.P.K. nuk ka plotësuar aneksin 6 sikurse është kërkuar me DT. Njëkohësisht nuk janë dorëzuar dokumentet e kërkuara me DT për menaxherin e projektit. Prandaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 3 – është gjetur se OE Elektrikamont ka dorëzuar diplomën për inxhinierin Skender Lezi, por nuk ka dorëzuar as referencë, as CV e as dokument tjetër që dëshmon përvojën e tij të punës 3 vjeçare. Prandaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 4 – është gjetur se OE Elektrikamont nuk e ka pLotoësuar fare kolonën D dhe as nuk ka bashkangjitur dokumentet e kërkuara në tërësi për të gjitha mjetet. Ndërsa për mjetin Eskavator 4x4 me lugë ngarkuese e ka paraqitur mjetin e njëjtë/identik me mjetin që e ka paraqitur edhe OE Besa Company për këtë

këkresë, ku të dy këta operator kanë siguruar marrëveshje për mjetin e njëjtë/ identik nga kompania nshp Bageri. Rrjedhimisht komisioni rivlerësues duhet të shqyrtoj nëse është e lejuar sipas LPP dhe DT që për të njëjtën pajisje të lidhet marrëveshje me qira për të njëjtin projekt por me dy OE të ndryshëm. Prandaj pretendimi është i bazuar pjesërisht.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 5 - është gjetur se është kamioni me traga të regjistrimit 01-629-OC, pastaj kamioni me traga të regjistrimit 01-826-JQ, kamioni kiper me traga të regjistrimit 01-611-MR kanë regjistrim jovalid. Prandaj pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 02.07.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.